



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 51

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 12 prill 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 14/2018 datë 29.3.2018	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për mbrojtjen shoqërore..... 2949
Vendim i Kuvendit nr. 59/2018, datë 5.4.2018	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 43/2017, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës” 2958
Vendim i Kuvendit nr. 60/2018, datë 5.4.2018	Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi..... 2960
Vendim i Kuvendit nr. 61/2018, datë 5.4.2018	Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë..... 2960
Rezolutë e Kuvendit datë 5.4.2018	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017..... 2967



LIGJ
Nr. 14/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË
AUSTRISË PËR MBROJTJEN
SHOQËRORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për mbrojtjen shoqërore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 29.3.2018

Shpallur me dekretin nr. 10759, datë 11.4.2018,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir
Meta

MARRËVESHJE
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE REPUBLIKËS SË AUSTRISË
PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Austrisë, të cilat në vijim do të quhen “shtete kontraktuese”, me dëshirën për të rregulluar marrëdhëniet e tyre reciproke në fushën e mbrojtjes shoqërore, bien dakord për marrëveshjen në vijim.

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimi i termave

1. Në këtë marrëveshje, termat e poshtëshënuar përkufizohen si vijon:

1) “Dispozita ligjore”, ligjet, aktet nënligjore, statutet dhe gjithë dispozitat e tjera të zbatueshme, të cilat u referohen degëve të Mbrojtjes Shoqërore, të përcaktuara në paragrafin 1, të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje;

2) “Autoritet kompetent” për Republikën e Austrisë: Ministrat Federalë, për Republikën e Shqipërisë: ministri ose ministrat kompetentë për dispozitat ligjore të përcaktuara në paragrafin 1, të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje;

3) “Institucion”, institucioni, detyra e të cilit është zbatimi i dispozitave ligjore të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje ose zbatimi i një pjese të tyre;

4) “Institucion kompetent”, institucioni kompetent, detyra e të cilit është zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse referuar rastit konkret;

5) “Vendbanim”, vendi i qëndrimit të zakonshëm;

6) “Vendqëndrim”, vendi i qëndrimit të përkohshëm;

7) “Periudha të sigurimit”, periudhat e pagesës së kontributit ose periudha të barasvlershme me to, të cilat njihen si të tilla sipas dispozitave ligjore të secilit shtet kontraktues;

8) “Anëtar i familjes”, një anëtar i familjes sipas dispozitave ligjore të shtetit kontraktues, në të cilin ka selinë institucioni kompetent, i cili ka në ngarkim shërbimet;

9) “Përfitim në para”, një pension ose një përfitim tjetër në para duke përfshirë të gjitha shtesat, kompensimet, rritjet dhe pagesat e njëhershme në kuptimin e dispozitave ligjore të përcaktuara në paragrafin 1, të nenit 2 të kësaj Marrëveshjeje; për sa i përket Austrisë, me përjashtim të kompensimit të rehabilitimit.

2. Në këtë marrëveshje termat e tjerë kanë kuptimin e përcaktuar sipas dispozitave ligjore të shtetit përkatës kontraktues.

Neni 2

Fusha lëndore e zbatimit

1. Kjo marrëveshje u referohet:

1) Dispozitave ligjore austriake për:

a) sigurimin shëndetësor;

b) sigurimin ndaj aksidenteve;

c) sigurimin e pensioneve, me përjashtim të sigurimeve të veçanta për noterët.

2) Dispozitave ligjore shqiptare për:



a) sigurimin shoqëror të detyrueshëm për pensionet, aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, barrë lindjet dhe sëmundjet;

b) vetëm për sa i takon pjesës II, sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

2. Kjo marrëveshje u referohet edhe të gjitha dispozitave ligjore, të cilat përmbledhin, amendojnë apo plotësojnë dispozitat ligjore të përcaktuara në paragrafin 1.

3. Kjo marrëveshje nuk u referohet dispozitave ligjore për një sistem të ri të mbrojtjes shoqërore, përveç rastit kur autoritetet kompetente bien dakord ndryshe nga si janë shprehur këtu.

Neni 3

Fusha personale e zbatimit

Kjo marrëveshje zbatohet:

1. Për personat, për të cilët janë ose kanë qenë të vlefshme dispozitat ligjore të njërit ose të të dyja shteteve kontraktuese;

2. Për persona të tjerë, për aq sa të drejtat e tyre rrjedhin prej personave të përcaktuar në pikën 1.

Neni 4

Trajtimi i barabartë

1. Për aq sa kjo marrëveshje nuk e parashikon ndryshe, në zbatimin e dispozitave ligjore të njëres palë personat e mëposhtëm janë të barabartë me shtetasit e kësaj pale:

a) shtetasit e palës tjetër;

b) refugjatët, në kuptim të nenit 1 të Konventës, të datës 28 korrik 1951, mbi statusin ligjor të refugjatëve dhe protokollit përkatës shtesë, të datës 31 janar 1967, të cilët e kanë vendbanimin në territorin e njërit prej shteteve kontraktuese;

c) personat pa shtetësi, në kuptim të nenit 1 të Konventës, të datës 28 shtator 1954, mbi statusin ligjor të personave pa shtetësi, të cilët e kanë vendbanimin në territorin e njërit prej shteteve kontraktuese;

d) cilido person tjetër, i cili është anëtar i familjes ose një familjar i mbijetuar dhe që ndodhet në territorin e njërit prej shteteve kontraktuese, për sa kohë të drejtat e tij rrjedhin prej një personi të parashikuar në këtë paragraf.

2. Për sa i përket Republikës së Austrisë, paragrafi 1 i këtij neni, në zbatimin e kësaj marrëveshjeje vlen edhe për shtetasit e një shteti

në të cilin aplikohet rregullorja nr. 883/2004 (KE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit.

3. Për sa i përket Republikës së Austrisë paragrafët 1 dhe 2 nuk cenojnë:

a) dispozitat ligjore në lidhje me pjesëmarrjen e të siguruarve dhe të punëdhënësve në organet e institucioneve dhe lidhjeve të shoqërive të sigurimit, sikurse edhe në juridiksionin në fushën e mbrojtjes shoqërore;

b) rregullat e mbulimit me sigurim në marrëveshjet ndërshtetërore me shtete të tjera;

c) dispozitat ligjore në lidhje me sigurimin e një personi të punësuar pranë një misioni diplomatik apo përfaqësie konsullore të Republikës së Austrisë në një shtet tjetër ose pranë anëtarëve të një institucioni të tillë.

4. Paragrafët 1 dhe 2 do të zbatohen sipas dispozitave ligjore austriake për marrjen në konsideratë të periudhave të shërbimit të luftës ose periudha të barasvlershme me to vetëm për shtetasit shqiptarë, të cilët kishin shtetësinë austriake përpara 13 marsit të vitit 1938.

Neni 5

Eksportimi i përfitimeve

1. Për aq sa nuk përcaktohet ndryshe nga kjo marrëveshje, përfitimet në para, për të cilat ka lindur e drejta sipas dispozitave ligjore të njërit prej shteteve kontraktuese, nuk lejohet të reduktohen, ndryshohen, pezullohen ose hiqen për shkakun se personi me këtë të drejtë e ka vendbanimin apo vendqëndrimin në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

2. Paragrafi 1 nuk u referohet:

a) për Republikën e Austrisë: shtesave për kompensim sipas dispozitave ligjore austriake dhe nuk u referohet pagesave të njëhershme si kompensim të fuqisë blerëse për përballimin e konsumit;

b) për Republikën e Shqipërisë: shtesave për kompensim mbi bazë vendbanimi sipas dispozitave ligjore shqiptare.

PJESA II

PËRCAKTIME MBI DISPOZITAT QË DUHEN ZBATUAR

Neni 6

Rregullime të përgjithshme

1. Sigurimi i detyrueshëm i një personi në marrëdhënie pune, për sa nuk përcaktohet ndryshe



nga nenet 7 deri në 9, përcaktohet sipas dispozitave ligjore të shtetit kontraktues, në territorin e të cilit personi ushtron aktivitetin e tij si i punësuar apo vetëpunësuar. Për personat e punësuar kjo vlen edhe për rastet kur vendbanimi i punëmarrësit ose selia e punëdhënësit ndodhet në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

2. Nëse një person, i cili e ka vendbanimin në njërin shtet kontraktues, për shkak të një vetëpunësimi me të ardhurat që rrjedhin prej tij, do t'i nënshtrohej njëkohësisht detyrimit për sigurim sipas dispozitave ligjore të të dy shteteve kontraktuese, atëherë për këtë person do të zbatohen vetëm dispozitat ligjore të shtetit kontraktues në të cilin ky person ka vendbanimin.

Neni 7

Persona të dërguar

Nëse një punëmarrës i një subjekti me seli në njërin prej shteteve kontraktuese dërgohet në territorin e shtetit tjetër kontraktues, deri në përfundimin e muajit të 24-t kalendarik që nga dërgimi vazhdojnë të zbatohen dispozitat e shtetit të parë kontraktues, sikur ai të ishte akoma i punësuar në territorin e këtij shteti.

Neni 8

Dispozita të veçanta

1. Një person që bën pjesë në personelin fluturues dhe atë të kabinës së një avionit dhe është i punësuar nga një kompani fluturimi me seli në njërin nga shtetet kontraktuese i nënshtrohet dispozitave ligjore të këtij shteti kontraktues.

2. Për një punëmarrës, i cili është pjesëtar i ekuipazhit udhëtues të një kompanie, e cila kryen aktivitetin e saj në transportin e udhëtarëve ose mallrave me anë të transportit rrugor, hekurudhor apo atij të brendshëm ujor me seli në territorin e njërit prej shteteve kontraktuese, zbatohen dispozitat ligjore të këtij shteti kontraktues.

3. Për ekuipazhin e një anijeje detare, si dhe për personat, të cilët zakonisht punojnë në bordin e një anijeje detare, zbatohen dispozitat ligjore të shtetit kontraktues, nën flamurin e të cilit lundron anija. Ky rregullim nuk zbatohet për persona si punëtorët e portit të cilët shkojnë në

bord për të kryer punë në një anije të ankoruar në port.

4. Për punëmarrës të shërbimit publik, të cilët dërgohen nga njëri shtet kontraktues në shtetin tjetër kontraktues, zbatohen dispozitat ligjore të shtetit kontraktues nga i cili ata dërgohen.

Neni 9

Personeli diplomatik dhe konsullor

1. Për anëtarët e përfaqësive diplomatike apo zyra konsullore, të cilët nuk janë nëpunës të shërbimit publik, si dhe për personat e punësuar privatisht në shërbim të anëtarëve të këtyre përfaqësive apo zyra, të cilët dërgohen në territorin e shtetit tjetër kontraktues, zbatohen dispozitat e shtetit kontraktues nga i cili ata dërgohen.

2. Për punëmarrësit e përcaktuar në paragrafin 1, të cilët nuk janë të dërguar, zbatohen dispozitat ligjore të shtetit kontraktues në të cilin ata punojnë.

Neni 10

Përfashtime

1. Me kërkesë të përbashkët të punëmarrësit dhe punëdhënësit të tij ose me kërkesë të personit të vetëpunësuar, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, në mirëkuptim me njëri-tjetrin, mund të bien dakord për përfashtime nga nenet 6 deri në 9, ku duhen marrë parasysh lloji dhe rrethanat e punësimit.

2. Nëse për një punonjës të punësuar ose të vetëpunësuar zbatohen sipas paragrafit 1 dispozitat ligjore të njërit shtet kontraktues, megjithëse ai punon në territorin e shtetit tjetër kontraktues, atëherë këto dispozita ligjore zbatohen njëjloj sikur ai të punonte në territorin e shtetit të parë kontraktues.

PJESA III

DISPOZITA TË VEÇANTA

KAPITULLI 1

SËMUNDJA DHE BARRËLINDJE

Neni 11

Përfitimet në para

1. Përfitimet në para jepen nga institucioni kompetent sipas dispozitave ligjore të zbatueshme për këtë institucion.



2. Nëse sipas dispozitave ligjore të njërit shtet kontraktues masa e përfitimit në para varet nga numri i anëtarëve të familjes, atëherë institucioni kompetent merr në konsideratë edhe anëtarët e familjes, të cilët banojnë në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

KAPITULLI 2 AKSIDENTET NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE

Neni 12

Përfitimet në para

1. Përfitimet në para jepen duke marrë parasysh nenet vijuese 13 dhe 14 nga institucioni kompetent sipas dispozitave ligjore të zbatueshme për këtë institucion.

2. Nëse sipas dispozitave ligjore të njërit shtet kontraktues masa e përfitimit në para varet nga numri i anëtarëve të familjes, atëherë institucioni kompetent merr në konsideratë edhe personat e tjerë të familjes, të cilët banojnë në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

Neni 13

Kompetenca në sëmundjet profesionale

1. Nëse sipas dispozitave ligjore të të dy shteteve kontraktuese parashikohet përfitim për një sëmundje profesionale, dhënia e përfitimit bëhet vetëm sipas legjislacionit të shtetit kontraktues në territorin e të cilit është ushtruar së fundmi ajo punë që mund të shkaktojë një sëmundje të tillë profesionale.

2. Nëse dhënia e përfitimit për një sëmundje profesionale sipas dispozitave ligjore të njërit shtet kontraktues kushtëzohet nga fakti që sëmundja të jetë konstatuar prej mjekut për herë të parë në territorin e këtij shteti kontraktues, atëherë ky kusht konsiderohet i përmbushur nëse sëmundja në fjalë është konstatuar për herë të parë në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

3. Nëse dispozitat ligjore të njërit shtet kontraktues parashikojnë dhënien e përfitimeve për një sëmundje profesionale, vetëm nëse veprimtaria e cila mund ta shkaktojë këtë sëmundje është ushtruar për një periudhë kohore minimale, atëherë institucioni kompetent i këtij shteti merr parasysh, nëse është e nevojshme, kohën e ushtrimit të një veprimtarie të tillë, për të cilën vlenin dispozitat ligjore të shtetit tjetër kontraktues.

Neni 14

Përfitimet në para për përkeqësimin e sëmundjes profesionale

Nëse një person, i cili ka pësuar një sëmundje profesionale, ka marrë ose merr përfitim në para nga një institucion i njërit shtet kontraktues dhe pasi ka ushtruar edhe një veprimtari sipas dispozitave ligjore të shtetit tjetër kontraktues, e cila mund të shkaktojë një sëmundje profesionale, kërkon përfitim në para për shkak të përkeqësimit nga një institucion i shtetit të dytë kontraktues, atëherë institucioni i shtetit të parë kontraktues do të vazhdojë të japë përfitimin në para sipas dispozitave ligjore që vlejnë për të, pa marrë parasysh përkeqësimin. Institucioni kompetent i shtetit të dytë kontraktues jep përfitimin në para sipas dispozitave ligjore në fuqi në masën që i korrespondon diferencës midis përfitimit në para që i detyrohet pas përkeqësimit dhe përfitimit në para që ai do të duhej të paguante përpara përkeqësimit, sipas dispozitave ligjore që vlejnë për atë, nëse sëmundja do të ishte shfaqur sipas këtyre dispozitave ligjore.

KAPITULLI 3

PENSIONET E PLEQËRISË, INVALIDITETIT, FAMILJARE DHE PËRFITIME TË TJERA NË PARA QË PAGUHEN NGA DEGA E SIGURIMIT TË PENSIONEVE

Neni 15

Mbledhja e periudhave të sigurimit

1. Nëse sipas dispozitave ligjore të njërit prej shteteve kontraktuese, marrja, ruajtja apo rifitimi i së drejtës për përfitim varet nga përmbushja e periudhave të sigurimit, atëherë institucioni kompetent për rastin konkret i këtij shtetit kontraktues, për aq sa është e nevojshme, duhet të marrë në konsideratë periudhat e sigurimit të përmbushura sipas dispozitave ligjore të shtetit tjetër kontraktues, njëloj sikur ato të ishin përmbushur sipas dispozitave ligjore që duhet t'i zbatohet ai vetë, për aq sa ato nuk i përkasin të njëjtës periudhë.

2. Nëse sipas dispozitave ligjore të njërit prej shteteve kontraktuese, pagesa e disa përfitimeve të caktuara varet nga përmbushja e periudhave të sigurimit në një profesion për të cilin ekziston një sistem (skemë) i/e veçantë sigurimesh ose në një



profesion, apo punë të caktuar, atëherë për dhënien e këtyre përfitimeve, periudhat e përmbushura të sigurimit sipas dispozitave ligjore të shtetit tjetër kontraktues merren në konsideratë, vetëm nëse ato përkojnë me sistemin (skemën) përkatës/e të sigurimeve ose nëse nuk ekziston një i tillë, atëherë vetëm nëse periudhat e sigurimit janë përmbushur në të njëjtin profesion ose në të njëjtën punë.

3. Nëse sipas dispozitave ligjore të njërit prej shteteve kontraktuese, periudhat e dhënies së pensionit zgjasin periudhat në të cilat duhet të jetë përmbushur siguri, atëherë këto periudha zgjaten edhe nëpërmjet periudhave përkatëse të dhënies së pensionit sipas dispozitave ligjore të shtetit tjetër kontraktues.

4. Periudhat e sigurimit të një personi në një shtet të tretë, me të cilin njëri prej shteteve kontraktuese në fjalë ka një marrëveshje të të njëjtit lloj për mbrojtjen shoqërore, duhen marrë gjithashtu në konsideratë për marrjen, ruajtjen dhe rifitimin e së drejtës për përfitim sipas dispozitave ligjore të këtij shteti kontraktues.

Neni 16

Periudhat e sigurimit nën 1 vit

1. Nëse periudhat e sigurimit, të cilat duhet të merren në konsideratë për llogaritjen e përfitimeve sipas dispozitave ligjore të njërit prej shteteve kontraktuese, nuk arrijnë totalin prej 12 muajsh dhe, bazuar vetëm në këto periudha siguri nuk lind e drejta për përfitim, atëherë sipas këtyre dispozitave ligjore nuk do të jepen përfitime.

2. Periudhat e sigurimit të përcaktuara në paragrafin 1 në lidhje me marrjen, ruajtjen apo rifitimin e së drejtës për përfitim dhe përmasat e saj, duhet të merren në konsideratë nga institucioni i shtetit tjetër kontraktues njëloj sikur ato të ishin periudha siguri të përmbushura sipas dispozitave ligjore të vetë atij shteti.

Neni 17

Përcaktimi i përfitimit

1. Nëse sipas dispozitave të njërit shtet kontraktues ekziston e drejta për përfitime edhe pa zbatimin e nenit 15, atëherë institucioni kompetent i këtij shteti kontraktues duhet ta përcaktojë përfitimin bazuar vetëm në periudhat e sigurimit të cilat duhen marrë në konsideratë sipas dispozitave ligjore të zbatueshme në këtë shtet.

2. Nëse sipas dispozitave ligjore të njërit shtet kontraktues, e drejta e përfitimit përfitohet vetëm nga zbatimi i nenit 15 të Marrëveshjes, atëherë institucioni kompetent i këtij shteti kontraktues duhet ta përcaktojë përfitimin sipas nenit 18 të Marrëveshjes ose sipas nenit 19 të Marrëveshjes.

Neni 18

Llogaritja për pjesën e përfitimeve nga Republika e Austrisë

1. Nëse sipas dispozitave ligjore austriake e drejta për përfitim konsiston vetëm përmes bashkimit të periudhave të sigurimit, sipas nenit 15 të Marrëveshjes, atëherë ky përfitim llogaritet në zbatim të rregullores nr. 883/2004 (KE) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, ku periudhat shqiptare të sigurimit konsiderohen si periudha siguri të një shteti tjetër anëtar të Bashkimit Evropian.

2. Në ndryshim me paragrafin 1, periudhat për rritjen e fëmijëve, për efekt të llogaritjes së përfitimeve nga këto periudha, merren në konsideratë vetëm në përputhje me dispozitat ligjore austriake.

Neni 19

Llogaritja për pjesën e përfitimeve nga Republika e Shqipërisë

Nëse sipas dispozitave ligjore shqiptare, e drejta për përfitim lind vetëm përmes bashkimit të periudhave të sigurimit sipas nenit 15 të Marrëveshjes, atëherë ky përfitim llogaritet duke marrë për bazë periudhat e sigurimit të realizuara sipas dispozitave ligjore shqiptare.

PJESA IV

DISPOZITA TË NDRYSHME

Neni 20

Marrëveshja e zbatimit, ndihma e ndërsjellë administrative dhe juridike

1. Autoritetet kompetente do të rregullojnë me një marrëveshje administrative masat e nevojshme administrative për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Autoritetet kompetente të të dyja shteteve kontraktuese njoftojnë njëri-tjetrin:

a) mbi masat e marra për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;



b) mbi ndryshimet e kryera në dispozitat e tyre ligjore që prekin zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

3. Në zbatimin e kësaj marrëveshjeje autoritetet dhe institucionet e shteteve kontraktuese duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe të veprojnë njëloj sikur të zbatonin dispozitat e veta ligjore. Kjo ndihmë e ndërsjellë është falas.

4. Autoritetet dhe institucionet e shteteve kontraktuese, me qëllim zbatimin e kësaj marrëveshjeje, mund të komunikojnë me njëri-tjetrin, si dhe direkt me persona të përfshirë ose të autorizuarit e tyre.

5. Autoritetet dhe institucionet e njërit prej shteteve kontraktuese nuk mund t'i refuzojnë kërkesat dhe dokumentet e dërguara te ta me shkakun se ato janë përpiluar në gjuhën zyrtare të shtetit tjetër kontraktues.

6. Kontrollat mjekësore të cilat kryhen vetëm në zbatim të dispozitave ligjore të njërit prej shteteve kontraktuese dhe kanë të bëjnë me persona të cilët kanë vendqëndrimin apo vendbanimin në territorin e shtetit tjetër, me kërkesë të institucionit kompetent, urdhërohen dhe mbikëqyren nga institucioni i shtetit ku personi ka vendqëndrimin apo vendbanimin dhe shpenzimet mbulohen nga institucioni kompetent kërkuar. Nëse kontrollat mjekësore kryhen në zbatim të dispozitave ligjore të të dyja shteteve kontraktuese, atëherë ato urdhërohen dhe mbikëqyren nga institucioni i shtetit ku personi ka vendqëndrimin apo vendbanimin, i cili mbulon edhe shpenzimet e kontroleve mjekësore.

Neni 21

Zyrat ndërlidhëse

Autoritetet kompetente, për të lehtësuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe veçanërisht për krijimin e një lidhjeje të thjeshtë dhe të shpejtë në mes të institucioneve përkatëse të shteteve kontraktuese, duhet të caktojnë zyra ndërlidhëse.

Neni 22

Përfshirja nga taksat dhe reduktimi i taksave - Përfshirja nga legalizimi

1. Çdo përfshirje apo reduktim i taksave ose i tarifave, parashikuar në dispozitat e njërit prej shteteve kontraktuese për vulat, gjykatat, noteritë dhe regjistrimet për dokumentet ose dëshmitë, të cilat duhen paraqitur në zbatim të këtyre dispozitave, duhet të aplikohet edhe për dokumen-

tet dhe dëshmitë të cilat duhen paraqitur në zbatim të kësaj marrëveshjeje ose dispozitave ligjore të shtetit tjetër kontraktues.

2. Dëshmitë dhe dokumentet e çdo lloji, të cilat duhen paraqitur në zbatim të kësaj marrëveshjeje, nuk duhen legalizuar.

Neni 23

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Kur në bazë të kësaj marrëveshjeje transmetohen të dhëna personale, vlejnë përcaktimet e mëposhtme, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të secilit shtet kontraktues:

1) Të dhënat, në zbatim të kësaj marrëveshjeje dhe të dispozitave ligjore të cilave ajo u referohet, lejohen t'u transmetohen zyrave kompetente të shtetit marrës. Shteti marrës lejohet t'i përdorë ato vetëm për këto qëllime. Transmetimi në zyra të tjera të shtetit marrës është i lejueshëm sipas legjislacionit të brendshëm të shtetit marrës, vetëm nëse u shërben qëllimeve të mbrojtjes shoqërore, si dhe proceseve gjyqësore që lidhen me të. Edhe në rastet e hapjes së informacioneve në kuadër të një procesi apo vendimi gjyqësor, konfidencialiteti mbi të dhënat personale lejohet të thyhet vetëm nëse kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e interesave mbizotërues legjitimë të një personi tjetër ose interesave mbizotërues publikë.

2) Nëse të dhënat personale transmetohen në kuadër të kësaj marrëveshjeje ose të marrëveshjes administrative për zbatimin e saj, pavarësisht formës së transmetimit, ato duhet të mbahen të fshehta ashtu si mbahen informacionet e të njëjtit lloj, të mbledhura, bazuar në legjislacionin e brendshëm të këtij shteti. Ky detyrim vlen për të gjithë personat e ngarkuar me zbatimin e detyrave në kuadër të kësaj marrëveshjeje, si dhe kundrejt personave të tjerë, të cilët kanë detyrimin e ruajtjes së sekretit.

3) Zyra marrëse, kur i kërkohet, në raste të veçanta, njofton zyrën transmetuese mbi përdorimin e të dhënave të transmetuara dhe mbi rezultatet e arritura.

4) Zyra transmetuese është e detyruar të kujdeset për saktësinë e të dhënave që do të transmetohen, si dhe për domosdoshmërinë lidhur me synimin për të cilin ato transmetohen. Në këtë kuadër duhet të respektohen dispozitat ndaluese të legjislacionit të brendshëm për transmetimin. Nëse rezulton se janë transmetuar të dhëna të pasakta



ose të dhëna, të cilat sipas legjislacionit të brendshëm të shtetit transmetues nuk lejohet të transmetohen, atëherë duhet të njoftohet pa vonesë zyra marrëse. Ajo është e detyruar t'i korrigjojë ose t'i fshijë ato menjëherë. Nëse zyra marrëse ka arsye të supozojë se të dhënat e transmetuara janë të pasakta ose do të duhej të fshihen, atëherë ajo njofton menjëherë zyrën dërguese.

5) Me kërkesë të personit të prekur, i cili provon identitetin e tij në një formë të përshtatshme, atij, pa vonesë të paarsyeshme dhe parimisht falas, nga zyra përgjegjëse duhet t'i vihen në dispozicion në formë përgjithësisht të kuptueshme të dhënat e transmetuara ose informacionet e përpunuara në lidhje me të, origjina e të dhënave, marrësit e mundshëm ose kategoritë e marrësve, synimi i parashikuar i përdorimit, si dhe baza ligjore në të cilën bazohet përpunimi dhe transmetimi. Përveç kësaj, personi i prekur ka të drejtën e korrigjimit të të dhënave të pasakta, si dhe të fshirjes së të dhënave të përdorura në mënyrë të jashtëligjshme. Nëse një person e konsideron veten të cenuar në të drejtën e tij për mbrojtjen e të dhënave personale, atëherë, bazuar në legjislacionin e brendshëm, ai ka të drejtën e ankimit pranë një gjykate të pavarur kompetente ose pranë një zyre tjetër të pavarur kompetente, e cila jep vendim të formës së prerë ligjore. Gjithashtu, personi i prekur ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim ose korrigjim të ndonjë lloji tjetër. Hollësitë e procedurës mbi zbatimin e këtyre të drejtave i referohen legjislacionit të brendshëm.

6) Shtetet kontraktuese përgjigjen bazuar në legjislacionin e brendshëm në lidhje me dëmin që i është shkaktuar një personi të prekur në shtetin përkatës kontraktues nga përpunimi dhe transmetimi i të dhënave personale në kuadër të kësaj marrëveshjeje.

7) Nëse zyra e njërit prej shteteve kontraktuese ka transmetuar të dhëna personale në kuadër të kësaj marrëveshjeje, zyra marrëse e shtetit tjetër kontraktues, në kuadër të mbajtjes së përgjegjësisë sipas legjislacionit të brendshëm, nuk mund të shfaqë kundërshtime kundrejt të dëmtuarit, bazuar në faktin se të dhënat e transmetuara kanë qenë të pasakta. Nëse zyra marrëse dëmshpërblen për një dëm të shkaktuar nga përdorimi i të dhënave të transmetuara padrejtësisht, atëherë zyra dërguese ia rimbursos zyrës marrëse shumën totale për dëmshpërblimin e paguar.

8) Të dhënat personale të transmetuara duhen fshirë nëse rezultojnë të pasakta, si dhe nëse mbledhja ose transmetimi i tyre nuk është bërë në mënyrë të ligjshme. Të dhënat personale duhen fshirë edhe nëse ato janë transmetuar në mënyrë të ligjshme, por legjislacioni i brendshëm i shtetit dërgues parashikon afate për fshirjen e të dhënave. Gjithashtu, ato duhen fshirë nëse ato nuk nevojiten më për qëllimin, për të cilin janë transmetuar dhe nuk ka arsye për të supozuar se nëpërmjet fshirjes së këtyre të dhënave cenohen interesat legjitimë të personit në fushën e mbrojtjes shoqërore.

9) Zyra transmetuese dhe zyra marrëse kanë detyrimin të dokumentojnë transmetimin dhe marrjen e të dhënave personale, duke regjistruar shkaktuesin, përmbajtjen, kohën, si dhe zyrën transmetuese dhe atë marrëse. Të dhënat e transmetuara *online* duhet të regjistrohen në mënyrë elektronike. Të dhënat e regjistruara duhet të ruhen për së paku tre vjet dhe lejohen të përdoren vetëm për verifikimin e pajtueshmërisë me legjislacionin përkatës mbi mbrojtjen e të dhënave.

10) Zyra transmetuese dhe zyra marrëse kanë detyrimin që të dhënat personale të transmetuara t'i mbrojnë në mënyrë të efektshme nga shkatërrimi i rastësishëm ose i paautorizuar, nga humbja e rastësishme, nga akseset (qasja e) paautorizuar, nga ndryshimet e paautorizuara ose të rastësishme, si dhe nga publikimi i paautorizuar.

2. Paragrafi 1 zbatohet edhe për sekretet e ndërmarrjes dhe ato tregtare.

Neni 24

Dorëzimi i kërkesave, deklaratave ose apelimeve

1. Kërkesat, deklaratat ose apelimet, të cilat në kuadrin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje ose të dispozitave ligjore të njërit prej shteteve kontraktuese, i dorëzohen një autoriteti, një institucioni (të sigurimeve shoqërore) apo një institucioni tjetër përkatës të njërit prej shteteve kontraktuese, duhet të trajtohen njëjloj si kërkesa, deklarata ose apeline të dorëzuara pranë një autoriteti, një institucioni (të sigurimeve shoqërore) apo një institucioni tjetër përkatës të shtetit tjetër kontraktues.

2. Një kërkesë për përfitim e bërë sipas dispozitave ligjore të njërit prej shteteve kontraktuese vlen edhe si kërkesë e bërë për përfitimin përkatës, sipas dispozitave ligjore të



shtetit tjetër kontraktues, kërkesë kjo e cila merret në konsideratë duke u referuar në këtë marrëveshje; kjo nuk vlen për rastet, kur kërkuesi kërkon shprehimisht shtyrjen e moshës së pleqërisë (pensionit) për përcaktimin e një përfitimi si e drejtë e fituar sipas dispozitave ligjore të njërit prej shteteve kontraktuese.

3. Kërkesat, deklaratat ose apelimet, të cilat në kuadrin e zbatimit të dispozitave ligjore të njërit prej shteteve kontraktuese duhet t'i dorëzohen brenda një afati të caktuar një autoriteti, një institucioni (të sigurimeve shoqërore) apo një institucioni tjetër përkatës të njërit prej shteteve kontraktuese, mund të dorëzohen brenda të njëjtit afat pranë zyrës përkatëse në shtetin tjetër kontraktues.

4. Në rastet e parashikuara në paragrafët nga 1 deri në 3, zyra tek e cila është bërë kërkesa, deklarimi apo apelimi, duhet ta transmetojë atë menjëherë, në mënyrë direkte ose nëpërmjet zyrave ndërlidhëse të shteteve kontraktuese, te zyra përkatëse e shtetit tjetër kontraktues.

Neni 25

Transaksionet e pagesave

1. Institucionet të cilat sipas kësaj marrëveshjeje kanë detyrimin e pagesave ndaj përfituesit, i cili e ka vendbanimin ose vendqëndrimin në territorin e shtetit tjetër kontraktues, mund t'i kryejnë ato në monedhën e shtetit të vet.

2. Rimbursimet e parashikuara nga kjo marrëveshje kryhen në monedhën e shtetit kontraktues ku ka selinë institucioni, i cili jep përfitimet ose kryen pagesën sipas dëshmipërblimit, referuar pikës 7, të paragrafit 1, të nenit 23.

3. Kursi përcaktues i këmbimit është ai i ditës në të cilën bëhet pagesa.

Neni 26

Procedurat e përmbarimit

1. Vendimet e përmbarueshme të gjykatave, si dhe dokumentet e ekzekutueshme të autoriteteve ose institucioneve të njërit prej shteteve kontraktuese mbi kontributet apo detyrime të tjera në kuadër të mbrojtjes shoqërore njihen në shtetin tjetër kontraktues.

2. Njohja lejohet të refuzohet vetëm në ato raste kur ajo është në kundërshtim me rendin publik të shtetit kontraktues, në të cilin kërkohet njohja e vendimit apo dokumentit.

Faqe | 2956

3. Vendimet dhe dokumentet e përmbarueshme, sipas paragrafit 1 ekzekutohen në shtetin tjetër kontraktues. Procedura e përmbarimit u referohet dispozitave ligjore të shtetit në territorin e të cilit do të kryhet përmbarimi, lidhur me ekzekutimin e vendimeve përkatëse të marra dhe dokumenteve përkatëse të lëshuara në këtë shtet. Ekzemplari i vendimit ose i dëshmisë duhet të përmbajë klauzolën e përmbarimit.

4. Kërkesat për pagesë të institucioneve në territorin e njërit prej shteteve kontraktuese në lidhje me kontributet e papaguara, gjatë ekzekutimit të detyrueshëm përmbarimor dhe procedurave të falimentit në territorin e shtetit tjetër kontraktues, trajtohen në të njëjtën mënyrë si kërkesat për pagesë korresponduese në territorin e këtij shteti.

Neni 27

Zbritja e paradhënieve dhe kërkesa për kthimin e përfitimeve të pamerituara

Nëse një institucion i njërit prej shteteve kontraktuese ka paguar një paradhënie, atëherë ajo mund të mbahet nga përfitimet, të cilat sipas dispozitave të shtetit tjetër kontraktues, duhen paguar për të njëjtën periudhë. Nëse institucioni i njërit prej shteteve kontraktuese, për një periudhë për të cilën institucioni i shtetit tjetër kontraktues duhet të paguajë më pas një përfitim të caktuar, por ka paguar një shumë më të lartë sesa përfitimi i merituar, atëherë shumën e paguar më tepër vlen si paradhënie, referuar fjalisë së parë.

Neni 28

Pretendimet e institucioneve ndaj palëve të treta përgjegjëse

1. Nëse, sipas dispozitave ligjore të njërit prej shteteve kontraktuese, paguhen dëshmipërblime për dëme të shkaktuara në territorin e shtetit tjetër kontraktues, atëherë e drejta (ose pretendimi) që mund t'i lindë institucionit përgjegjës kundrejt një pale të tretë përgjegjëse për dëshmipërblim, rregullohet si vijon:

a) nëse pretendimet që ka përfituesi kundrejt palës së tretë, sipas dispozitave ligjore që vlejnë për institucionin përgjegjës, i janë kaluar këtij institucioni, atëherë secili nga shtetet kontraktuese e njeh këtë kalim;

b) nëse institucioni përgjegjës ka një pretendim direkt ndaj palëve të treta, atëherë secili nga shtetet kontraktuese njeh këtë pretendim.



2. Nëse pretendimi për kompensim në lidhje me përfitime të njëlojshme nga i njëjti rast, dëmi i lind si një institucioni të njërit prej shteteve kontraktuese, ashtu edhe një institucioni të shtetit tjetër, atëherë pala e tretë e përcaktuar në paragrafin 1 mund të bëjë pagesën në njërin prej këtyre institucioneve. Në marrëdhëniet me njëri-tjetrin, institucionet e ndajnë atë në raport me detyrimin që kanë për të paguar përfitimin.

Neni 29

Bashkëpunimi në luftën kundër mashtrimit

Krahas zbatimit të parimeve të përgjithshme të bashkëpunimit administrativ, autoritetet kompetente mund të bien dakord në kuadrin e një marrëveshjeje administrative për rregullime në lidhje me bashkëpunimin për të luftuar mashtrimin tejkuftar për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe përfitimet nga sigurimet dhe sidomos për sa u përket vendbanimit faktik të personave, konstatimit të të ardhurave, përlllogaritjes së kontributeve dhe mënjanimin të përfitimeve të dyfishta.

Neni 30

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje duhet të zgjidhen nga autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese.

2. Mosmarrëveshjet të cilat nuk mund të zgjidhen brenda gjashtë muajve, sipas paragrafit 1, duhet të zgjidhen në rrugë diplomatike.

PJESA V

RREGULLIMET KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 31

Rregullimet kalimtare

1. Nga kjo marrëveshje nuk lindin pretendime për periudhën përpara hyrjes së saj në fuqi.

2. Për njohjen e së drejtës dhe llogaritjen e përfitimit në bazë të kësaj marrëveshjeje merren në konsideratë edhe periudhat e sigurimit të plotësuar sipas dispozitave ligjore të njërit prej shteteve kontraktuese përpara hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

3. Në zbatimin e paragrafit 2, periudhat e sigurimi të plotësuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, përpara 27 nëntorit 1961, të cilat sipas dispozitave ligjore austriake mbi pretendimin dhe të drejtat për përfitimin e pensionit, për shkak të

punësimit jashtë vendit, duhet të konsiderohen si periudha sigurimi, njihen ekskluzivisht si periudha sigurimi austriake.

4. Pa cenuar paragrafin 1, kjo marrëveshje zbatohet edhe për raste sigurimi të lindura përpara hyrjes së saj në fuqi, për aq sa e drejta e mëhershme nuk është shuar nga pagesat e bëra. Në këtë rast, përfitimet në para të lidhura me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, rishikohen me kërkesë të përfituesit. Nëse kërkesa bëhet brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, atëherë përfitimet duhen paguar që nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, përndryshe duke filluar nga dita që është caktuar sipas dispozitave ligjore të secilit shtet kontraktues.

5. Pa cenuar paragrafin 4 përfitimet e përcaktuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje nuk llogariten nga e para.

6. Në zbatim të nenit 7, periudha e quajtur aty si periudhë e dërgimit të personit i cili është dërguar në shtetin tjetër kontraktues përpara hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, fillon me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Neni 32

Rregullimet përfundimtare

1. Kjo marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit. Dokumentet e ratifikimit do të shkëmbehen sa më shpejt të jetë e mundur.

2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të tretë pas muajit në të cilin shkëmbehen dokumentet e ratifikimit.

3. Kjo marrëveshje lidhet për një kohë të pacaktuar. Secili shtet kontraktues mund ta anulojë atë me shkrim, në rrugë diplomatike, duke iu përmbajtur afatit më së paku tre muaj përpara mbarimit të vitit kalendarik. Në këtë rast, marrëveshja zbatohet vetëm deri në ditën e fundit të këtij viti kalendarik.

4. Në rast anulimi të kësaj marrëveshjeje, e drejta për përfitim e fituar deri në atë moment, mbetet e vlefshme.

Për ta dëshmuar, të autorizuarit kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Bërë në _____, më _____, në dy origjinale, secili në gjuhën gjermane dhe shqipe, ku të dyja tekstet janë njëloj autentike.

Për Republikën e Shqipërisë:

Për Republikën e Austrisë:

**VENDIM
Nr. 59/2018****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 43/2017 “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE
ORGANIKËS SË AUTORITETIT TË
KONKURRENCËS”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Autoritetit të Konkurrencës,


Lidhja nr. 1

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

- I. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, të vendimit të Kuvendit nr. 43/2017, ndryshohen sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 5.4.2018

STRUKTURA E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS



Lidhja nr. 2

**ORGANIKA E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS, SHOQËRUAR ME
KATEGORIZIMIN E PAGËS PËR ÇDO POZICION**

POZICIONI	NUMRI
I. KRYETAR	(1)
II. KOMISIONER	(4)
III. KABINETI	(3)
Drejtor kabineti	1
Këshilltar	1
Sekretar	1
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	(1)
V. DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË TREGJEVE PRODHUESE	(6)
Drejtor II-b	1
Inspektor III-a	5
VI. DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË TREGJEVE TË SHËRBIMIT/JOPRODHUESE	(6)
Drejtor II-b	1
Inspektor III-a	5
VII. DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE	(6)
Drejtor II-b	1
Inspektor III-a	5
VIII. DREJTORIA JURIDIKE DHE E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE	(6)
Drejtor II-b	1
Inspektor për vlerësimin e legjislacionit III-a	3
Inspektor për procedurat e hetimit III-a	2
IX. DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE KOMUNIKIMIT	(5)
Drejtor II-b	1
Specialist III-b	4
X. DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	(5)
Drejtor II-b	1
Specialist financë/buxhet III-b	1
Specialist protokoll/arkiv IV-a	1
Shofer Kl. IV (VKM nr. 717, datë 23.6.2009, i ndryshuar)	1
Punonjës pastrimi	1
Gjithsej:	(43)

**VENDIM
Nr. 60/2018****PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONERIT PËR
MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 23 e 25, të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi prej 28 deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Zoti Robert Gajda zgjidhet Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 5.4.2018

Aneks 2**VENDIM
Nr. 61/2018****PËR MIRATIMIN E KODIT TË
SJELLJES SË DEPUTETIT
TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 75, pika 2, të Kushtetutës, dhe të neneve 40 e 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:****KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1
Qëllimi**

1. Kodi i Sjelljes së Deputetit ka për qëllim:

a) të orientojë deputetin të ushtrojë detyrën e tij, duke përcaktuar parimet etike, sipas standardeve të duhura të sjelljes dhe të forcojë integritetin e tij gjatë kohëzgjatjes së mandatit;

Faqe | 2960

b) të mundësojë veprimtarinë e deputetit në një mjedis bashkëpunues e besimi reciprok;

c) t'i mundësojë deputetit të zgjedhë drejtimin e duhur të sjelljes në situata të ndryshme të dilemës etike për ta mbrojtur atë ndaj presioneve të pahijshme;

ç) të rrisë transparencën e veprimtarisë së deputetit dhe përgjegjshmërinë e tij për të forcuar besimin te publiku;

d) të orientojë publikun e gjerë, për të ofruar një grup të qartë standardesh etike, në bazë të cilave të mundësojë komunikimin dhe vlerësimin e marrëdhënieve me deputetin.

2. Në përmbushje të qëllimit, sipas pikës 1, të këtij neni, Kodi përmban rregullat bazë mbi standardet e sjelljes së deputetit gjatë ushtrimit të veprimtarisë parlamentare dhe të veprimtarisë joparlamentare, që prek funksionin e deputetit.

3. Në këtë Kod, termi “deputet” nënkupton cilindo person, pavarësisht gjinisë.

Neni 2**Fusha e veprimtimit**

1. Kodi zbatohet për të gjitha aspektet e jetës publike të deputetit. Ai nuk rregullon aspektet e jetës private, përveçse kur jeta private e tij cenon dukshëm besimin publik te deputeti dhe institucioni i Kuvendit.

2. Detyrimet e këtij Kodi përmbushen duke respektuar rregullat procedurale të parashikuara në Kushtetutë, në Rregulloren e Kuvendit dhe në legjislacionin në fuqi.

Neni 3**Parime të përgjithshme të etikës**

Deputeti, gjatë ushtrimit të mandatit, duhet:

a) të jetë besnik ndaj atdheut dhe popullit;

b) të veprojë në interes të popullit dhe të udhëhiqet nga interesi i gjerë publik në veprimtarinë e tij dhe në marrjen e vendimeve;

c) të veprojë në përputhje me besimin që i ka dhënë populli;

ç) të zbatojë me rigorozitet Kushtetutën, ligjet, Rregulloren e Kuvendit dhe dispozitat e këtij Kodi;

d) të veprojë në përputhje me të drejtat dhe detyrimet që parashikohen në legjislacionin në fuqi për statusin e deputetit;

dh) të udhëhiqet nga parimet e ligjshmërisë, ndershmërisë, objektivitetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë;



e) të shmangë konfliktin e interesit me detyrën dhe të mos shfrytëzojë pozitën për interesin e tij personal;

ë) të jetë model për zgjedhësit dhe të sillt në mënyrë që të nxisë zbatimin e standardeve më të larta të sjelljes edhe për të rinjtë që përfshihen në politikë;

f) të ruajë konfidencialitetin e informacionit, të klasifikuar si të tillë, që ka në zotërim, për shkak të funksionit që ai kryen, pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi.

Neni 4

Detyrat e deputetit

1. Deputeti merr pjesë rregullisht në veprimtarinë parlamentare dhe jashtëparlamentare të Kuvendit, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

2. Deputeti ushtron nismën ligjvënëse dhe mbikëqyr zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera të miratuara nga Kuvendi, Këshilli i Ministrave, institucionet e pavarura, ministritë ose organet e qeverisjes vendore.

3. Deputeti merr takime periodike me zgjedhësit, vetë ose kur e kërkojnë ata. Ai i përfaqëson ata duke u marrë mendime për nisma ligjvënëse, amendamente, vendime dhe çështje të tjera që harton, shqyrton dhe miraton Kuvendi.

4. Deputeti shpenzon kohë pune të arsyeshme/nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij parlamentare në zyrën e caktuar në selinë e Kryesisë së Kuvendit.

KREU II

SJELLJA NË KUVEND

Neni 5

Dispozitë e përgjithshme

1. Deputeti, gjatë ushtrimit të mandatit, shfaq standardet më të larta të sjelljes së qytetëruar, dinjitoze dhe të etikës parlamentare korrekte.

2. Deputeti përfshin dhe trajton pa diskriminim dhe me humanizëm shqetësimet e nevojat e zgjedhësve që përfaqëson në diskutimet e debatet në seancë plenare dhe në komisionet parlamentare, në shqyrtimin dhe miratimin e dokumenteve parlamentare e planeve të veprimit, si dhe në aktet ligjore që miraton.

Neni 6

Gjuha joparlamentare dhe diskriminuese

1. Përdorimi në Kuvend i gjuhës së pahijshme, fyese ose kërcënuese, ofendimet dhe sulmet fizike personale janë rreptësisht të ndaluara.

2. Deputeti i ndalohet:

a) të përdorë një gjuhë të shprehuri, e cila nxit urrejtjen në bazë të racës, gjinisë, moshës, origjinës kombëtare, përkatësisë etnike, besimit fetar, prejardhjes sociale, aftësisë së kufizuar, gjendjes ekonomike, arsimore, shoqërore ose shëndetësore, gjendjes civile, familjare ose martesore, orientimit seksual, identitetit gjinor, përgjegjësisë prindërore, predispozicionit gjenetik, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër;

b) të shfaqë forma diskriminimi dhe stereotipizimi në komunikimin e përditshëm, në fjalime politike, në veprimtari parlamentare ose jashtëparlamentare ku merr pjesë.

3. Në rast të shkeljeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, ndaj deputetit zbatohen masat disiplinore, sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit.

Neni 7

Votimi për të tretët

1. Gjatë votimit në Kuvend dhe në komisione, deputeti ndalohet të votojë në emër të një kolegu tjetër, i cili nuk është i pranishëm në sallë.

2. Deputeti që nuk është i pranishëm në procesin e votimit, ndalohet që t'i delegojë votën e tij një kolegu.

3. Votimi për të tretët konsiderohet shkelje e rëndë e Kodit të Sjelljes së Deputetit dhe e Rregullores së Kuvendit.

Neni 8

Paraqitja e deputetit në veprimtaritë parlamentare

1. Deputeti, në komisionet parlamentare, në seancë plenare dhe në veprimtaritë e tjera parlamentare:

a) ruan solemnitetin dhe imazhin e Kuvendit;

b) shfaq tiparet më të mira të personalitetit të tij;

c) i drejtohet kolegut me fjalë kortezie;

c) paraqitet me veshje zyrtare në përshtatje me funksionin që kryen. Për qëllim të këtij neni, veshja e deputetit duhet të përmbushë standardet e



profesionalizmit dhe të modestisë, pa u bërë shkak debati dhe tërheqje vëmendjeje nga publiku;

d) mban marrëdhënie profesionale dhe kolegjiale me shërbimet e Kuvendit dhe personat e tjerë të angazhuar në punimet parlamentare.

2. Deputetët i ndalohet:

a) të paraqitet në gjendje të mungesës ose të uljes së ndjeshme të ekuilibrit fizik dhe/ose mendor për shkak të konsumimit të alkoolit dhe/ose të substancave narkotike ose psikotrope;

b) të kryejë veprime të tjera ose gesticulacione të pahijshme, përçmuese dhe ofenduese ndaj kolegëve, administratës së Kuvendit dhe të ftuarve, që ndikojnë negativisht në perceptimin e publikut për deputetin.

3. Gjatë veprimtarisë parlamentare, si rregull, deputeti nuk duhet të përdorë telefoninë e lëvizshme ose mjete të tjera, që tregojnë mungesë respekti ndaj kolegut, veprimtarisë parlamentare ose publikut dhe pengon mbarëvajtjen e punimeve parlamentare.

4. Kuvendi krijon mundësi për gruan deputete dhe staf Kuvendi, që kanë fëmijë të porsalindur, të marrë pjesë në punimet parlamentare bashkë me të. Kuvendi rishikon në mënyrë të vazhdueshme kushtet dhe kulturën e punës. Kuvendi siguron mundësi të barabarta për cilindo, si për deputetin dhe për stafin mbështetës.

Neni 9

Përdorimi i burimeve dhe stafit

1. Deputeti përdor kohën e punës, burimet, stafin dhe pronën e Kuvendit vetëm për të kryer detyrën që i është ngarkuar.

2. Deputeti nuk duhet ta vendosë stafin e Kuvendit, që paguhet nga fondet publike, në pozita që bien ndesh me paanësinë politike të stafit, ose ta përdorë atë për qëllime politike.

Neni 10

Ndalimi i ngacmimit seksual

1. Deputetët i ndalohet çdo sjellje me natyrë seksuale që prek dinjitetin e cilitdo dhe që konsiderohet e padëshiruar, e papranueshme, e papërshtatshme dhe ofenduese për personin tjetër, si dhe krijon një mjedis pune shqetësues, të paqëndrueshëm, armiqësor dhe frikësues. Për qëllim të këtij neni, sjellja e deputetit përfshin dhe nuk kufizohet në veprime fizike, fjalë, gjeste ose çdo lloj komunikimi virtual.

Faqe | 2962

2. Deputeti përpiket të sigurojë dhe të mbajë një mjedis pune pa ngacmime seksuale. Ai reagon menjëherë, raporton, kërkon evidentimin dhe hetimin e rastit, kur merr dijeni të ndonjë pretendimi për ngacmim seksual, duke mundësuar që viktimat e ngacmimit seksual të mos frikësohet, të mos denigrohet dhe të mos injorohet pretendimi i saj.

Neni 11

Mirësjellja e deputetit

1. Gjatë zhvillimit të seancave plenare, mbledhjeve të organeve të Kuvendit e komisioneve parlamentare dhe në veprimtaritë e tjera parlamentare, deputeti u drejtohet të tretëve me mirësjellje “i/e nderuar”.

2. Kur deputeti i ri mban fjalimin e parë në foltoren e Kuvendit, ai përshëndetet nga drejtuesi i seancës, respektohet nga të gjithë deputetët pjesëmarrës në sallë, pavarësisht grupimit politik që i përket.

3. Deputeti që bën diskutim/deklaratë në seancë plenare ose në mbledhje të komisionit dhe me fjalimin e tij i adresohet një kolegu ose një anëtar të Këshillit të Ministrave, në respekt të fjalës së mbajtur, qëndron në seancë/mbledhje për të dëgjuar të paktën deri në dy ndërhyrje të tjera nga kolegët.

Neni 12

Orientimi dhe këshillimi i deputetit

1. Në çdo fillim mandati të Kuvendit zhvillohen veprimtari orientimi, këshillimi dhe shkëmbimi të përvojave ndërmjet deputetëve të rinj dhe atyre me përvojë të gjatë legislative, si dhe shërbimeve mbështetëse të Kuvendit.

2. Kodi i Sjelljes së Deputetit, si dhe të gjitha aktet ligjore bazë që kanë lidhje me ushtrimin e funksionit të deputetit u vihen në dispozicion të gjithë deputetëve, grupeve parlamentare dhe partive politike që përfaqësohen në Kuvend.

3. Deputeti, para se të veprojë për një çështje etike, kur është në dyshim për rrjedhën e veprimit të kryer prej tij, ose që mund të kryejë, mund të konsultohet me një organ të caktuar.



KREU III KONFLIKTI I INTERESIT DHE DEKLARIMI E KONTROLLI I PASURIVE

Neni 13

Konflikti i interesit

1. Konflikti i interesit është situata kur një deputet është subjekt i një interesi privat, që mund të ndikojë në kryerjen siç duhet të përgjegjësi dhe detyrave publike.

2. Deputeti, kur ndodhet në një situatë konflikti interesi, deklaron gojarisht në fillim të seancës plenare ose të mbledhjes së komisionit apo organeve të tjera parlamentare. Deklarimi regjistrohet në procesverbalin e mbledhjes përkatëse. Kopje e procesverbalit i dorëzohet shërbimit përgjegjës për deputetët.

3. Kur një deputet, gjatë procesit ligjvënës, është subjekt i një interesi privat dhe mund të ndikohet nga çështja në shqyrtim, bën deklaratë me shkrim dhe e dorëzon pranë shërbimit përgjegjës për deputetët. Deklarata me shkrim e deputetit për konfliktin e interesit, rast pas rasti, publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

4. Deputeti nuk ka të drejtë të votojë për një projektligj ose dokument tjetër politik kur ka konflikt interesi dhe as të promovojë projektligje ose interesa për shpërblim/pagesë apo për përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta.

5. Deklarata me shkrim e deputetit për konfliktin e interesit, rast pas rasti, publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

6. Rregullat për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e mandatit të deputetit përcaktohen në legjislacionin përkatës për parandalimin e konfliktit të interesit.

Neni 14

Regjistri i deklarimit rast pas rasti të konfliktit të interesit

Shërbimi përgjegjës për deputetët mban një regjister të veçantë për rastet e deklarimit të konfliktit të interesit rast pas rasti.

Neni 15

Deklarimi dhe kontrolli i pasurisë

1. Rregullat për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, të detyrimeve financiare për deputetin, për familjarët e tij dhe për personat e lidhur me të

përcaktohen në legjislacionin përkatës për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe të detyrimeve financiare në formën e përcaktuar nga Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).

2. Deputeti, në rast nevojë, kërkon këshillim për plotësimin e deklaratës së pasurisë dhe dorëzon deklaratën e plotësuar të pasurisë dhe detyrimeve financiare pranë shërbimit përgjegjës për deputetët.

Neni 16

Publikimi i deklaratës

Deklarata e interesave privatë është dokument zyrtar dhe publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit në internet, me të dhënat konfidenciale personale të redaktuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe në legjislacionin përkatës për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe të detyrimeve financiare.

Neni 17

Kufizime gjatë ushtrimit të mandatit

1. Gjatë ushtrimit të mandatit, deputetit nuk i lejohet:

a) të ushtrojë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave;

b) të kryejë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojë pasuri të këtyre;

c) të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse;

ç) të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, të noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agentit a përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara në shkronjën “a” të këtij neni dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;

d) të zotërojë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, nëse ajo rezulton me pozitë dominuese në treg.

2. Kufizimi i përcaktuar në pikën 1, shkronja “b”, përfshin edhe ndalimin për të aplikuar dhe/ose fituar të ardhura direkte ose indirekte nga procedurat e tenderimit të autoriteteve prokuruese publike nga shoqëria tregtare, e



zotëruar në mënyrë aktive nga deputeti, qoftë edhe pjesërisht, dhe prej së cilës ai është larguar për shkak të fillimit të mandatit të deputetit.

3. Pronësia aktive nënkupton ushtrimin e plotë të të gjitha të drejtave që rrjedhin nga pronësia, aksionet ose pjesë të kapitalit.

4. Pozita dominuese në treg vlerësohet nga autoriteti përgjegjës për konkurrencën, sipas legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës.

5. Kuvendi mund të kërkojë nga autoriteti përgjegjës për konkurrencën të kryejë vlerësime për një kompani, në të cilën një deputet ka aksione ose kapital, për të vlerësuar nëse ka pozitë dominuese në treg.

6. Nëse aksionet ose pjesët e kapitalit regjistrohen në emër të një të afërmi, që do të thotë bashkëshortit/bashkëjetuesit, fëmijët e rritur, prindërit e deputetit, ato konsiderohen të njëjtë sikur të ishin të regjistruar në emër të vetë deputetit dhe të drejtat për pronën e të afërmeve kufizohen në të njëjtën masë dhe mënyrë si në rastin e vetë deputetit.

Neni 18

Koha e fillimit të ndalimit

1. Ndalimi i ushtrimit të aktivitetit fitimprurës, në kuptim të shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 17, të këtij Kodi, fillon ditën që deputeti shpallet i zgjedhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

2. Në rast të konstatimit të shkeljeve, çështja dërgohet në Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 70, pika 4, të Kushtetutës.

Neni 19

Kufizimi i imunitetit

1. Deputeti nuk duhet të përfitojë nga imuniteti i tij për të penguar veprimet e drejtësisë për të kërkuar arrestin, heqjen e lirisë në çfarëdo formë, ose ushtrimin e kontrollit personal a të banesës për kryerjen e një krimi të rëndë, përfshirë korrupsionin dhe shpërdorimin e detyrës.

2. Kodi i Sjelljes së Deputetit nuk kufizon të drejtat dhe imunitetin e deputetit, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe Rregullorja e Kuvendit.

3. Procedura për heqjen e imunitetit rregullohet nga legjislacioni në fuqi.

Neni 20

Veprimtaria joparlamentare e lejuar e deputetit

1. Veprimtari joparlamentare e lejuar e deputetit është çdo lloj veprimtarie, që deputeti zhvillon jashtë ushtrimit të funksionit të tij zyrtar, që nuk bie ndesh me ndalimet e parashikuara në Kushtetutë dhe në legjislacionin në fuqi.

2. Deputeti mund të ushtrojë veprimtari të tjera të ligjshme joparlamentare, në qoftë se një gjë e tillë nuk paraqet konflikt interesi me detyrën e tij zyrtare dhe nuk vjen në kundërshtim me kufizimet e nenit 17, pika 1, të këtij Kodi.

3. Në rast të kryerjes së një veprimtarie joparlamentare, sipas pikës 2, të këtij neni, deputeti njofton kryetarin e grupit dhe/ose Kryetarin e Kuvendit.

4. Gjatë veprimtarisë joparlamentare deputeti shmang kontaktet e jashtme që mund të dëmtojnë besimin në punën e tij.

Neni 21

Lobimi në Kuvend

1. Marrëdhëniet e deputetit me lobistët dhe organizatat e shoqërisë civile ose grupeve të interesit udhëhiqen nga parimet e integritetit dhe transparencës.

2. Transparenca e kontakteve të deputetit me lobistët, organizatat e shoqërisë civile, grupeve të interesit zbatohet për të gjitha rastet, përfshirë kontaktet jashtë mbledhjeve të Kuvendit dhe komisioneve të tij.

3. Kur deputeti ose komisionet parlamentare bashkëpunojnë me organizatat e shoqërisë civile ose grupet e interesit në procesin legjislativ, ai duhet të bëjë publike takimet me ta, objektin e diskutimeve dhe shkallën e mbështetjes që do të sigurojë për kërkesat e paraqitura nga subjektet kërkuuese.

4. Marrëdhëniet e deputetit ose komisioneve parlamentare me organizatat e shoqërisë civile ose grupet e interesit për çështjet që kanë lidhje me pjesëmarrjen në procesin legjislativ, duhet të jenë të dokumentuara. Këto dokumente depozitohen në komisionet parlamentare ose në sekretarinë e Kuvendit.



5. Dokumentet shkresore që kanë lidhje me kërkesa apo propozime konkrete në procesin legjislativ, publikohen në faqen zyrtare të komisionit parlamentar.

6. Deputetit i ndalohet të llobojë në këmbim të pagesave, stimujve ose shpërblimeve të tjera.

Neni 22

Regjistri i grupeve të interesit dhe shoqërisë civile

1. Deputeti regjistron çdo takim me palët e jashtme, që i shërbejnë atij për të lobuar në një çështje të veçantë, si masë politike ose legjislative.

2. Në Kuvend krijohet regjistri i lobimit, grupeve të interesit dhe organizatave të shoqërisë civile që mbajnë marrëdhënie me deputetin dhe komisionet parlamentare, me qëllim pjesëmarrjen e publikut në procesin legjislativ. Regjistri administrohet nga shërbimi përgjegjës për deputetët.

3. Regjistri publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit. Ai është i ndarë në bazë të fushave të përgjegjësisë së komisioneve të përhershme parlamentare.

4. Regjistri përditësohet çdo fillim legjislature, bazuar në thirrjen publike të interesit që Kuvendi u drejton organizatave dhe grupeve të interesit që janë të interesuara të bashkëpunojnë me të.

Neni 23

Dhuratat dhe përfitime të tjera të ngjashme

1. Deputeti nuk mund të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata me vlerë mbi 10 mijë lekë, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat.

2. Dhuratat, favorët, premtimet ose trajtimet preferenciale të siguruar ose të ofruara për një deputet konsiderohen se i janë ofruar atij në lidhje me pozicionin e tij, përveç rasteve kur janë përjashtuar në mënyrë specifike nga kriteret e parashikuara në pikën 6 të këtij neni.

3. Deputeti, të cilit i janë ofruar dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet:

a) t'i refuzojë ato dhe, në rast se ofrimi është kryer pa dijeninë e tij ose paraprakisht, t'ia kthejë mbrapsht ofruesit ose, në pamundësi, t'i dorëzojë zyrtarisht pranë shërbimit përgjegjës në Kuvend

për administrimin e objekteve me vlerë, të cilat më pas përdoren për qëllime të veprimtarisë së institucionit;

b) në rast se ofrimi ose dhënia e të mirave të sipërpërmendura lidhen me kryerjen e një vepre penale, deputeti bën kallëzim pranë organit të ndjekjes penale.

4. Dhuratat, që kanë vlera artistike, muzeale ose historike administrohen në institucion dhe ekspozohen.

5. Dhuratat që deputeti merr nga anëtarët e familjes (bashkëshorti/tja / bashkëjetuesi/sja, fëmijët e rritur, prindërit dhe të afërmit deri në shkallë të tretë) nuk konsiderohen si dhuratë, në kuptimin e pikës 1, të këtij neni, përveç rasteve kur ato janë dhurata të ofruara në mënyrë indirekte nga dikush tjetër.

6. Dhuratat e zakonshme të mikpritjes tradicionale, dhuratat me vlerë simbolike ose mirësjelljeje, brenda kufijve normalë të zakoneve tradicionale, të cilat nuk ngrenë dyshime lidhur me kryerjen e paanshme të detyrës nga ana e deputetit, nuk duhet të konsiderohen si dhurata, në kuptim të pikës 1 të këtij neni.

7. Deputeti mund të pranojë dhurata nga institucionet homologe ose organizatat ndërkombëtare, brenda kufijve normalë të shprehjes së mikpritjes dhe trajtimit që buron prej saj, ose protokollit, nëse nuk:

a) tejkalohen kufijtë e traditës dhe të zakoneve të vendit ku jepen;

b) vënë në dyshim objektivitetin dhe ndershmërinë e deputetit;

c) komprometojnë imazhin dhe integritetin e Republikës së Shqipërisë.

8. Kur deputeti përfaqëson zyrtarisht Kuvendin, dhuratat e pranuar, sipas pikës 6, të këtij neni, administrohen nga Kuvendi.

9. Dhuratat dhe përfitimet e ngjashme, sipas këtij neni, të refuzuara ose të pranuar nga deputeti, deklarohen brenda 5 ditëve dhe regjistrohen në një regjistër të posaçëm të Kuvendit.

10. Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin përcakton modalitetet e administrimit nga Kuvendi të dhuratave të pranuar, si dhe të mbajtjes së regjistrit.



KREU IV TRANSPARENCA DHE MBROJTJA E INFORMACIONIT GJATË USHTRIMIT TË DETYRËS

Neni 24

Transparenca e veprimtarisë parlamentare të deputetit

1. Gjatë ushtrimit të mandatit të tij, deputeti është transparent në komunikimin me zgjedhësit, me publikun dhe me median.

2. Një deputet duhet të ushtrojë të drejtat e tij në Kuvend me transparencë maksimale. Çdo propozim ligjor i paraqitur prej tij në çdo fazë të procedurës legislative, çdo kontribut tjetër në vendimet politike ose në vendime të tjera të marra në Kuvend shoqërohet me një justifikim të qartë.

3. Deputeti jep pëlqimin për publikimin në faqen e Kuvendit në internet të deklaratës së pasurisë së tij.

4. Byroja e Kuvendit autorizon publikimin e shpenzimeve financiare të kryera nga Kuvendi për çdo deputet në faqen zyrtare të internetit çdo dy muaj.

Neni 25

Transparenca e projekteve me Kuvendin

Kur organizatat e shoqërisë civile ose grupet e interesit kanë siguruar fonde për projekte që sigurojnë asistencë për hartim legjislativ, në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me Kuvendin, brenda 2 muajve nga miratimi i ligjit, bëjnë transparencën financiare të projektit dhe publikojnë shpenzimet në faqen zyrtare të Kuvendit.

Neni 26

Ruajtja e informacionit të klasifikuar

Pas mbarimit të mandatit, deputeti nuk duhet ta përdorë për interes personal informacionin konfidencial të klasifikuar si të tillë, të marrë gjatë kryerjes së detyrës.

Neni 27

Kufizim pas përfundimit të mandatit

1. Gjatë ushtrimit të funksionit, deputeti kryen detyrat e tij parlamentare pa u ndikuar nga mundësia e përfuturit në karrierën e tij të ardhshme në sektorin privat, ose pa u ndikuar nga ish-kolegët.

2. Një vit nga përfundimi i mandatit, deputeti nuk mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale konsulence ose kontratë pune biznesi ose individuale me Kuvendin ose të veprojë si avokat i paguar, palë kundërshtare, në çështje ku Kuvendi është palë.

KREU V

VLERËSIMI DHE INTERPRETIMI I KODIT TË SJELLJES

Neni 28

Vlerësimi periodik dhe rishikimi i Kodit

1. Kodi i Sjelljes së Deputetit, 6 muaj përpara përfundimit të legjislaturës, i nënshtrohet vlerësimit të plotë të standardeve etike të miratuara dhe për ndikimin që këto standarde kanë pasur në punën politike të deputetit. Ky vlerësim kryhet nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin të paktën 6 muaj përpara përfundimit të legjislaturës.

2. Raporti i vlerësimit i paraqitet Kuvendit në seancë plenare dhe publikohet.

3. Çdo deputet, grup parlamentar apo komision i përhershëm mund të ndërmarrë nismën për rishikimin dhe ndryshimin e Kodit, bazuar në çështjet që paraqet raporti, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Vlerësimi për zbatimin e Kodit bëhet në një takim konsultativ me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit që bashkëpunojnë ngushtë me Kuvendin.

Neni 29

Interpretimi i Kodit të Sjelljes

1. Kur ngrihen pretendime lidhur me interpretimin e këtij Kodi gjatë zhvillimit të seancës plenare, të mbledhjeve të komisioneve apo gjatë zhvillimit të mbledhjeve të organeve të Kuvendit, është kompetencë e drejtuesit të seancës /komisionit/organit përkatës për të vendosur për pretendimin e ngritur, vendim i cili nuk është objekt diskutimi.

2. Deputeti i interesuar, brenda 2 ditëve, mund t'i paraqesë kërkesë Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, i cili, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës, duhet të bëjë interpretimin përfundimtar për çështjen e pretenduar në pikën 1 të këtij neni.



3. Për rastet e tjera është kompetencë e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin që të bëjë interpretimin e neneve të këtij Kodi. Kërkesa për interpretim nga ky Këshill mund të bëhet nga çdo deputet.

4. Kryetari i Kuvendit, një kryetar grupi parlamentar, një komision i përhershëm ose 10 deputetë mund të kërkojnë që çështja e interpretimit për një rast të veçantë t'i paraqitet Kuvendit në seancë plenare për të marrë vendim.

KREU VI DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 30 Dispozita kalimtare

1. Deri në krijimin e infrastrukturës elektronike të nevojshme të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, deputeti depoziton pranë shërbimit përgjegjës për deputetët pëlqimin me shkrim për publikimin, në faqen zyrtare të Kuvendit në internet, të deklaratës, sipas nenit 16 të këtij Kodi.

2. Publikimi do të bëhet pas konsultimit me organin shtetëror përgjegjës për mënyrën e mosshfaqjes së të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Publikimi i deklaratës bëhet për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit, për deputetin që deklaron me shkrim pëlqimin për publikim.

4. Pëlqimi me shkrim dorëzohet pranë shërbimit përgjegjës për deputetët dhe është i vlefshëm deri në mbarimin e mandatit, me përjashtim të rastit kur deputeti deklaron me shkrim tërheqjen e pëlqimit.

Neni 31 Autoriteti përgjegjës për zbatimin e Kodit

Byroja e Kuvendit është autoriteti përgjegjës për zbatimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit.

Neni 32 Nxjerrja e udhëzimit të detajuar

Byroja e Kuvendit, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij Kodi, nxjerr udhëzuesin e detajuar për sjelljen në Kuvend.

Neni 33 Statusi i vendimit

Ky Kod bëhet pjesë e Rregullores së Kuvendit si aneksi nr. 2 i saj.

Neni 34 Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 5.4.2018

REZOLUTË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR VITIN 2017

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:

- Rolin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si institucion i pavarur dhe autoriteti përgjegjës që mbikëqyr dhe monitoron të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar;

- Rolin aktiv të Zyrës së Komisionerit në rritjen e ndërgjegjësimit të Autoriteteve Publike për detyrimet e tyre mbi hartimin dhe publikimin e programeve të transparencës dhe dhënien e informacionit publik;

- Angazhimin e Zyrës së Komisionerit për rritjen e numrit të inspektimeve dhe verifikimit të rekomandimeve në sektorë të ndryshëm që mbledhin e përpunojnë të dhëna personale;

- Zhvillimin e trajnimeve lidhur me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale për kontrolluesit publik dhe privat.

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2017:

- Zyra e Komisionerit ka kryer inspektime pranë Autoriteteve Publike, me qëllim kërkimin e informacionit lidhur me publikimin e programeve të transparencës, caktimit të koordinatoreve për të drejtën e informimit dhe publikimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.



- Ka rënie të numrit të ankesave pranë Zyrës së Komisionerit krahasuar me një vit më parë në lidhje me të drejtën për informimit, tregues ky që lidhet edhe me rritjen e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike në dhënien e informacionit të kërkuar.

- Është rritur numri i ankesave të drejtuara nga qytetarët pranë Zyrës së Komisionerit në krahasim me numrin e ankesave të depozituara nga organizatat e shoqërisë civile lidhur me garantimin e të drejtës për informim.

- Është rritur numri i ankesave nga qytetarët, në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si një tregues i ndërgjegjësimit të tyre mbi të drejtat që i garanton ky ligj.

- Zyra e Komisionerit ka vazhduar me monitorimin dhe mbikëqyrjen e përpunimit të të dhënave personale, në kontrollues publik dhe privat, kryesisht në sektorë të mëdhenj, duke dalë edhe me rekomandime unifikuese në sektorë të veçantë.

- Është rritur numri i hetimeve administrative me iniciativë të Zyrës së Komisionerit në sektorë të ndryshëm.

- Është rritur roli i Zyrës së Komisionerit në dhënien e mendimeve ligjore për projektakte ligjore e nënligjore, me synim përputhshmërinë e legjislacionit të brendshëm me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2018, kërkon nga Zyra e Komisionerit:

- Të angazhohet maksimalisht si institucion përgjegjës për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga VKM-ja “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit”.

- Të rrisë hetimet proaktive me iniciativë lidhur me procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale të qytetarëve nga kompanitë e mëdha publike dhe private.

- Të rrisë masat administrative për shkelje ligjore të konstatuara, për mungesën e programeve të transparencës, regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve dhe caktimin e koordinatorit, me fokus të veçantë ministritë dhe organet e pushtetit qendror.

- Të angazhohet për pasurimin e programeve të transparencës së institucioneve publike dhe jopublike, me informacione që kanë të bëjnë me objektivat për zhvillimin e qëndrueshëm, në kuadër dhe të rezolutës së Kuvendit të dhjetorit 2017 “Për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara”.

- Të angazhohet për hartimin e projektakteve normative që përafrojnë plotësisht dispozitat e paketës së re ligjore të BE-së në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale: Rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016 (Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) dhe Direktivën (BE) 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016 (Direktiva për mbrojtjen e të dhënave të personave fizikë gjatë procesit penal).

- Të rrisë kontrollet dhe hetimet administrative lidhur me respektimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

- Të hartojë dhe të miratojë modelin e programit të transparencës për organet e vetëqeverisjes vendore.

- Të monitorojë në vazhdimësi mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” mbi plan tematik, duke synuar unifikimin e praktikave në sektorë të ndryshëm.

- Të monitorojë zbatimin e rekomandimeve /urdhrave të dhëna nga Zyra e Komisionerit, me fokus institucionet publike.

- Të rrisë aktivitetet ndërgjegjëse me autoritetet publike, qytetarët, kontrolluesit publikë e privatë, shoqërinë civile, për të dy fushat e veprimtarisë që mbulon Zyra e Komisionerit, të dhënat personale dhe të drejtën e informimit.

- Të forcojë kapacitetet institucionale nëpërmjet trajnimeve dhe bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë.

**KRYETARI
Gramoz Ruçi**

Miraturar në datën 5.4.2018

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë